

PROCESVERBAL
nga mbledhja e 37-të e Këshillit të Agjencisë për
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
të mbajtur më datë 29.09.2022

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /

Në mbledhje ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: m-r Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, m-r Ivona Mufisheva, m-r Akesandar Xhuvareviq, Maja Damevska, d-r Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 37-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:15 dhe u realizua në hapësirat e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi si vijon:

R E N D D I T E

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 36-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më datë 29.09.2022.
2. Propozim për miratimin e plotësimit të Planit vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-563/2 nga data 08.02.2022.
3. Propozim-vendim për ndarjen e ndihmës financiare – donacionit për EF-EM 90.3 – Sportsko Radio SHPKNJP import-eksport Shkup, për organizimin e jubileut të 30-të “Turneu në futboll të vogël për mediume 2022”.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë në pamundësi teknike për ta përgatitur dokumentin e propozuar, e prolongoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së 36-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më datë 29.09.2022, gjatë seancave të ardhshme.

Pika 2

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozimin për miratimin e plotësimit të Planit vjetor të furnizimeve publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-563/2 nga data 08.02.2022. Sqaroi se ndryshimet janë të lidhura me ato pika që u ndryshuan në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2022, respektivisht Projektim,

furnizim, montim, realizim dhe lidhje në rrjetin energjetik të një centrali fotovoltik, që do të vendoset në selinë e Agjencisë dhe për një Studim fizibiliteti për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi plotësimin e Planit vjetor të furnizimeve publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-563/2 nga data 08.02.2022, me tekstin e propozuar.

Plani ekzistues vjetor i furnizimeve publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, plotësohet si vijon:

- në Kreun I. Kontrata dhe marrëveshje kornizë të furnizimeve publike për mallra shtohen 2 (dy) furnizime publike – Energji elektrike (furnizimi i përhershëm publik Pika 3 është realizuar në tërësi) si dhe Pika nr. 10 dhe Projektimi, furnizimi, montimi, realizimi dhe lidhja në rrjetin energjetik të një centrali fotovoltik, që do të vendoset në selinë e Agjencisë, si Pika nr.11.

- në Kreun II. Kontrata dhe marrëveshje kornizë të furnizimeve publike të shërbimeve shtohet 1 (një) furnizim publik - Studim fizibiliteti për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele si Pika nr. 40 me që të gjitha furnizimet janë në Kreun II, atëherë në mënyrë përkatëse zhvendosen për 1 (një) vend, edhe atë:

nr.	Lëndë e kontratës së furnizimit publik/marrëveshjes kornizë	Lloji i marrëveshjes për furnizim publik	Lloji i procedurës	Fillimi i pritshëm i procedurës (muaji)	Vlera e vlerësuar e furnizimit/marrëveshjes kornizë pa TVSH
I.	Kontrata dhe marrëveshje kornizë për furnizime publike të mallrave				
10.	Energjia elektrike	Mall	Procedurë e hapur	Shtator/tetor	13.340.000,00
11.	Projektimi, furnizimi, montimi, realizimi dhe lidhja në rrjetin energjetik të një centrali fotovoltik, që do të vendoset në selinë e Agjencisë	Mall	Procedurë e hapur e thjeshtësuar	Sipas nevojës	3.474.500,00
II.	Kontrata dhe marrëveshje kornizë për furnizime publike me shërbime				
40.	Studim fizibiliteti për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele	Shërbim	Furnizim në vlerë të vogël	tetor	338.980,00

Sektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike të përpilojë një tekst të spastruar të Planit vjetor për furnizime publike të Agjencisë.

Pika 3

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozim-vendimin për ndarjen e ndihmës financiare – donacionit për EF-EM 90.3 – Sportsko Radio SHPKNJP import-eksport Shkup, për organizimin e jubileut të 30-të “Turneu në futboll të vogël për medime 2022”. Sqaroi se nga ana e këtij radiodifuzeri përmes Qeverisë është kërkuar që të sigurohen mjete financiare për organizimin e turneut në fjalë. Nga Qeveria janë përgjigjur pozitivisht, duke u dhënë rekomandim për Agjencinë që të ndajë mjete në kuadër të mundësive të tyre, e që janë 250.000,00 denarë. Pas miratimit të vendimit nga Këshilli, do të nënshkruhet Marrëveshje me radiodifuzerin ndërsa do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së RMV-së.

Z. Petrushevski tha se edhe më parë janë dhënë donacione dhe procedura është e njëjtë, fillimisht i jepet leje drejtorit, më pas përgatitet vendimi, shkon në Ministrinë e Drejtësisë që kontrollojnë nëse është sipas Ligjit, jepen miratimet dhe lidhjet Marrëveshja.

Z. Trajçev tha se e sheh shkresën e shefit të zyrës së Kryetarit të Qeverisë ku shkruan se “...i jepet Agjencisë në kuadër të kompetencave të saja..” dhe pyeti nëse ASHMAA ka kompetencë ligjore dhe mundësi financiare për ta realizuar këtë vendim?

Z. Trajçevski sqaroi se me ndryshimin, respektivisht me rritjen e Planit Financiar ka mundësi financiare dhe gjithsesi se ka edhe mundësi ligjore për të bërë donacione, sepse konsiderohet se është interes publik. Këtë do ta konfirmojë ose refuzojë Ministria e Drejtësisë, nëse konfirmon se bëhet fjalë për projekt me interes publik do të japë leje që të realizohet pagesa nëse konkludohet se nuk është ashtu, do të kemi përgjigje negative dhe si rrjedhojë donacioni nuk do të realizohet.

Z. Fidanoski tha se sipas tij, kjo ngjarje është me interes publik, bëhet fjalë për jubileun e 30-të të turneut që organizohet nga radiodifuzeri EF-EM 90.3 – Sportsko Radio SHPKNJP nga Shkupi, që veç më edhe është e njohur në publik, shumë prej ekipeve të gazetarëve mediatik garojnë këtu. Kjo është një lloj i nevojës për një komunikim më të mirë të komunitetit mediatik dhe për këtë arsye konsideroj që është mirë Këshilli të jap përkrahje.

Z. Petrushevski sqaroi se kjo ngjarje ka edhe karakter ndërkombëtar.

Z. Ajdini tha se ekziston një fjalë e urtë që thotë: “bëj atë që mund me atë që e ke”. Këto mjete janë shumë të rëndësishme për radion, veçanërisht në drejtim të promovimit të sportit, përmbajtjeve sportive dhe gjithashtu shtetit në tërësi. Është mirë që në kohë krize flitet për sportin dhe kulturën dhe për këto arsye tha se do ta përkrah propozimin.

Z. Petrushevski u prononcua se do ta përkrah propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha leje drejtorit të Agjencisë, për Vendim për ndarje të ndihmës financiare – donacion EF-EM 90.3 – Sportsko Radio SHPKNJP import-eksport Shkup në shumë prej 250.000,00 (dyqind e pesëdhjetë mijë) denarë, me qëllim të përkrahjes së aktivitetet e radiodifuzerit për organizimin e jubileut të 30-të “Turneu në futboll të vogël për medime 2022”, që do të kontribuojë për promovimin e sportit profesional dhe rekreativ,

stimulimin dhe zhvillimin e kulturës dhe përmbajtjeve sportive, si dhe afirmimin e shprehive të shëndosha sportive dhe kulturës fer-plej.

Mjetet e lartpërmendura financiare, janë paraparë me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për vitin 2022 dhe të njëjtat paguhen në llogarinë e EF-EM 90.3 – Sportsko Radio SHPKNJP import-eksport Shkup numër 300000002196892, deponues Banka Komerciale SHA Shkup, numri tatimor 4030998342288.

Për ndihmën e ndarë financiare – donacionin, lidhet Marrëveshje për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe EF-EM 90.3 – Sportsko Radio SHPKNJP import-eksport Shkup, që hy në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e të dy palëve, ndërsa do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së RMV-së.

Sektori për Përkrahjen e Punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Të ndryshme

Z. Jançeski në lidhje me Turneun ndërkombëtar në futboll të vogël të mediave 2022, prozoi që edhe Agjencia të merr pjesë me përfaqësues të saj.

Z. Petrushevski tha se i pëlqen propozimi dhe mund të pranohet.

**Nr. 02-3547/4
06.10.2022**

Shkup

**Agjencia për shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**